



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.906/22**

**GJYKATA KOMERCIALE**-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit ....., me seli n Ferizaj, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat Visar Musa, ndaj të paditurës Dogana e Kosovës ,të cilën e përfaqëson sipas autorizimit K.K, duke vendosur për konfliktin e kompetencës ndërmjet Departamentit për Çështje Ekonomike dhe Departamentit të Përgjithshëm, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.10.2022

### **A K T V E N D I M**

Për të gjykuar në këtë çështje juridike me kompetencë lëndore dhe territoriale është Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë, të cilës i dërgohen shkresat e lëndës në procedurë të mëtejme.

### **A r s y e t i m**

Me padinë e parashtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, paditësi ka kërkuar që të obligohet e paditura, që në emër të pasurimit të pabazë, t'ia paguaj shumën prej 1,311.00€.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin C.nr. 2361/2017, të datës 10.10.2020, është shpallë jokompetente për të vendosur në këtë çështje dhe pas plotëfuqishmërisë së aktvendimit lëndën ia ka dorëzuar në procedim të mëtejme Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamentit për Çështje Ekonomike

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me propozimin e datës 27.08.2021, ka iniciuar konfliktin e kompetencës duke konsideruar së Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës s Par është kompetente lëndore dhe teritoriale për vendosje në këtë çështje juridike.

Gjykata Komerciale si gjykatë e shkallës së dytë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vlerëson se kompetente për të vendosur në këtë çështje juridike është Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë.

Dhoma e Shkallës së Dytë sipas detyrës zyrtare gjeti se me nenin 13 par 1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale është përcaktuar kompetenca lëndore e Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë dhe Dhoma e Shkallës së Dytë si vijon: “Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë është kompetente në pikëpamje lëndore, për shkak se nga referati i padisë rezulton se palët ndërgjyqëse janë shoqëri tregtare dhe me padi pretendohet se në mes tyre janë krijuar marrëdhënie juridiko-detyrimore me karakter afarist për të cilat kompetente për të vendosur është Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë, si e vetmja gjykatë me kompetencë lëndore për të vendosur në këto çështje juridike.

Nga të cekurat konform Nenit 25.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos sikurse në dispozitiv.

## **GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë**

**K.DH.SH.II.nr.906/22, data 27.10.2022**

**Kryetarja e kolegjit-Gjyqtarja**  
Saranda Bogaj Sheremeti